

VENDIM
Nr. 8, datë 22.2.2023

**PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 420, DATË 29.9.2022, “PËR LICENCAT
DHE TARIFAT E SHËRBIMIT TË OPERATORËVE UK DERI NË PËRFUNDIM
TË PROCEDURAVE TË RIORGANIZIMIT DHE TRANSFERIMIT TË
SHOQËRIVE UK NË SUBJEKTE ME KOMPETENCA TË PËRBASHKËTA”**

Në zbatim të neneve 14, gjerat “e” dhe “i” dhe 19, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, ndryshuar, dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 302, datë 11.5.2022, “Për politikat kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura”, në të cilin edhe ERRU-ja ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi, Komisioni Kombëtar Rregullator, duke pasur në konsideratë periudhën kohore që iu nevojitet njësive të vetëqeverisjes vendore dhe shoqërive UK për përfundimin e procedurave të riorganizimit në Subjekte me Kompetenca të Përbashkëta (SKP-UK), si edhe aplikimin për tarifa të reja sipas vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 539, datë 30.12.2021, “Për miratimin e metodologjisë dhe procedurës për miratimin e tarifave të shërbimeve ujësjellës-kanalizime”,

VENDOSI:

Pas pikës 3, të vendimit nr. 420, datë 29.9.2022, shtohet pika 3/1, me këtë përmbajtje:

Shoqëritë SKP-UK gjatë periudhës tranzitore, për zonat e shërbimit që janë bërë pjesë e tyre, të cilat nuk kanë pasur tarifa të miratuara nga ERRU për shërbimet UK të ofruara ndaj konsumatorëve, do të përdorin tarifat aktuale me të cilat janë faturuar konsumatorët e këtyre zonave të shërbimit përpara reformës deri në miratimin e tyre nga Komisioni Kombëtar Rregullator. Gjithashtu zonat e bardha (pa shërbim) dhe pa infrastrukturë inxhinierike të cilat nuk kanë qenë të shërbyera më parë nga shoqëritë UK ekzistuese, por ndërkohë janë plotësuar me infrastrukturë inxhinierike për ofrimin e shërbimeve të furnizimit me ujë, do të konsiderohen si pjesë e zonës së shërbimit dhe do të aplikohen tarifat e shoqërive UK ekzistuese sipas bashkive përkatëse deri në miratimin e tyre nga Komisioni Kombëtar Rregullator.

2. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi të gjitha shoqëritë UK dhe SKP-UK, si dhe të gjitha strukturat e ERRU-së.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Ndriçim Shani